

Projektet në ADMINISTRATË

- **Sensorët për matjen e ndotjes së ajrit**

Janë instaluar sensorët për matjen e ndotjes së ajrit në gjashtë pika kyçe të qytetit. Përveç parametrin aktual, do të pasqyrohet edhe norma e ndotjes së lejuar sipas rregulloreve të BE-së, në mënyrë që parametrat të krahasohen.

Parametrat që maten janë:

Dioksidi i sulfurit (SO₂)

Hidrogjensulfidi (H₂S)

Ozoni (O₃)

Grimcat PM₁₀ dhe PM₂₅

Monoksidi i karbonit (CO)

Amoniaku (NH₃)

Radioaktiviteti

Decibel metër - matës i zhurmës dhe temperatura.

Sensorët janë vendosur në lagjet:

Bregu i Diellit, rruga: Enver Maloku;

Dodona, rruga: Afrim Loxha;

Dardania, rruga: Ilaz Kodra;

Ulpiana, rruga: Mujë Krasniqi;

Qendër, sheshi "Zahir Pajaziti";

Kodra e Trimave, rruga: Vëllezërit Fazliu.

Të gjitha këto rezultate për secilën pikë mund të lexohen në faqen elektronike të Komunës së Prishtinës -- > <http://air.fara.rocks>

- **Votimi digjital në Kuvendin Komunal të Komunës së Prishtinës**

Është bërë instalimi i pajisjes për votimin digjital në Kuvend. Me këtë kemi eliminuar votimin me dorë, duke përmirësuar vendimmarrjen në Kuvendin komunal.

- **Tabelat orientuese - INFOGRAFIKAT**

Janë instaluar tabelat orientuese për qytetarë, për t'i informuar dhe drejtuar tek sportelet në Administratë, Kadastër dhe Urbanizëm.

- **Pajisja e punonjësve me uniformë**

Të gjithë punonjësit janë të uniformuar dhe bartin ID kartelën, në mënyrë që të mund të identifikohen lehtë, nëse qytetari ka vërejtje.

- **Krijimi i sistemit të integruar të menaxhimit të radhës dhe one-stop shop në objektin e ri**

Është instaluar sistemi i integruar i menaxhimit të radhës, i cili ka përmirësuar shërbimet e Komunës, si dhe ka lehtësuar procesin e marrjes së dokumenteve personale dhe ka ulur kohën e pritjes nga 2-4orë në më pak se 5 minuta. Tani për të gjitha dokumentet aplikohet, paguhet dhe vulosen në një sportel. Poashtu, në kuadër të këtij projekti është edhe marrëveshja me postën e kosovës, të cilët janë prezent me sportelet e tyre në Komunën e vjetër dhe Komunën e re, ashtu që qytetarët të mund t'i bëjnë pagesat e tatimit në pronë dhe pagesat e tjera menjëherë pa pasur nevojë për të pritur.

- **Digjitalizimi i shërbimeve në stacionin e autobusëve**

Me këtë sistem, të gjithë ata të cilët e kanë pagesën mujore dhe ata që i kryejnë shërbimet brenda stacionit, sistemi i pranon në mënyrë automatike dhe hapet me automatizëm laura, pas leximit të tabelave të regjistrimit. Kemi edhe formën e dytë për persona që duan të kryejnë shërbime vetanake brenda stacionit, fillimisht e marrin tiketën, më pas lejohen për të hyrë brenda, ndërsa pagesa bëhet në shalterin nr. 2. Kjo është faza fillestare e digjitalizimit të stacionit të autobusëve duke pasur parasysh se në të ardhmen do të bëhet digjitalizimi i të gjitha shërbimeve në stacion.

- **E-kiosku**

E-kiosku është një shërbim i ri, i pari i këtij lloji në Ballkan. Ky është vetëshërbimi digjital për certifikatat, ekstraktet apo shërbimet e gjendjes civile ku gjithsejt janë 5 dokumente. Ky shërbim do të jetë në dispozicion 24 orë në ditë, 7 ditë në javë dhe qytetarët të cilët janë të regjistruar në regjistrin civil, si dhe kanë nxjerrë edhe më parë një ekstrakt, në çfarëdo kohe përmes një procesi tejet të thjeshtë, me letërnjoftimin e tyre mund t'i shtypin 5 dokumentet e gjendjes civile.

- **E-rekrutimi - Transparencë e plotë në punësim**

Platformë e cila mundëson aplikim "online" për pozitat e lira në Komunë dhe përcjelljen e procesit të rekrutimit për aplikacionet e kandidatëve që kanë aplikuar dhe numrin e pikëve të arritura.

- **Faqja e re elektronike e Komunës PRISHTINA ONLINE**

Është dizajnuar dhe strukturuar në nivel më të lartë, por duke iu përmbajtur Udhëzimit administrativ për mirëmbajtjen e faqeve elektronike. Linku për webfaqe: www.prishtinaonline.com

- **Vulat në çdo bashkësi lokale**

Deri më tani qytetarët, pas marrjes së vërtetimit, është dashur që të drejtohen në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës për ta vulosur atë vërtetim. Tash e tutje vërtetimi plotësohet, lëshohet dhe vuloset nga referenti i bashkësisë lokale. Kjo nënkupton se qytetarët nuk kanë nevojë më që për vulosjen e vërtetimit të vijnë në objektin e Komunës.

- **Certifikata Online**

Përmes këtij shërbimi, Komuna e Prishtinës do ta përmirësojë shërbimin ndaj qytetarëve, duke i shmangur kështu pritjet në radhë të gjata si dhe në të njëjtën kohë duke shtuar efikasitetin e punës së administratës komunale.

Ky shërbim kushton 2 euro për dokument, pas aplikimit, brenda dy ditëve të punës, dokumenti arrin në adresën e aplikuesit, dhe i dorëzohet në dorë nga ana e postierit.

Dokumentet të cilat mund të aplikohen online janë:

- 1. EKSTRAKTI I LINDJES**
- 2. CERTIFIKATA E LINDJES**
- 3. CERTIFIKATA E MARTESËS.**
- 4. CERTIFIKATA E VENDBANIMIT**
- 5. CERTIFIKATA E SHETËSISË**

6. CERTIFIKATA E GJENDJES MARTESORE

7. CERTIFIKATA E VDEKJES.

- **Zgjatja e orarit për ofrimin e shërbimeve komunale**

Është zgjatur orari i punës për Zyrën e Gjendjes Civile për shërbimet ndaj qytetarëve, prej 08:30 - 17:30 (e hënë - e premte), si dhe ditën e Shtunë orari është 09:00 - 12:00.

- **Vendim për ndryshim të orarit të pushimit për punonjësit civil në shërbim të qytetarëve**

Të gjitha shërbimet në ndërtesën e vjetër të Komunës, ato të ofiqarisë, shërbimit për qytetarë, dhe ato të tatimit në pronë, do të jenë të hapura për qytetarët nga ora 08:30 deri në 15:00 pandërprerë. Shërbimet me qytetarë nuk do të jenë të mbyllura gjatë pauzës së drekës.